



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 20.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregulativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-1, mori këtë:

### VENDIM

Aprovohet pjesërishtë- si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-11, dhe

Njoftimi për Kontratë e AK-së, të datës 27.03.2023.

Autoriteti Kontraktues, vodos që të bëjë korigjimin e dosjes së tenderi, duke e korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet me ketë aktivitet .

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### Arsyimet

Operatori ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K., si palë e pakënaqur me datë 31.03.2023 ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues të Komunës së Gjilanit kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-1 dhe me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit dhe analizës konkrete në mënyrë të drejtë të gjitha faktave dhe provave të administruara, gjeti dhe konstatoi se Kërkesat për Rishqyrtim të parashtruesve aprovoohen si pjesërishtë të bazuara.

#### Pretendimi ankimor i parë :

Oferta financiare, respektivisht hartimi i paramasës dhe parallogarisë është bërë jashtë standardeve të formave të aplikuara nga AK dhe të aprovuara nga ana e KRPP-së dhe në kundërshtim me praktikën e ofertave financiare të AK-së në Republikën e Kosovës.

Vet lloji i kontratës dhe numri referent (5) i aktivitetit tregon se nga ana e AK-së kjo kontratë është klasifikuar si kontratë për punë dhe jo kontratë e furnizimeve. Prandaj duhet të llogaritet kostojë për njësi të punës qoftë me metër katror, kg apo qfarëdo pune që parashihet në kontratë. Çmimet duhet të ofertoohen për punë që nënkupton që në të njejtin çmim për njësi hyn edhe furnizimi për punët pasi që puna dhe furnizimi detyrimisht janë të lidhura me njëra tjetër dhe nuk mund të ndahen nga njëra tjetra siç është verpruar në rastin konkret. Sipas ofertave financiare (paramasës dhe parallogarisë) të prodhua nga sistemi e-prokurimi e lejojnë vetëm një çmim për një pozicion dhe jo që për një pozicion të kërkohen dy çmime siç është vepruar në rastin konkret.

Kjo ofertë financiare (paramasë dhe parallogari) është shabillon i cili është kopjuar apo marrë nga një kompani private që në rastin konkret është KEDSI dhe si e tillë zbatimi i saj është në kundërshtim me përgaditjen dhe praktikën e ofertave financiare të AKsë në Republikën e Kosovës. Një formë e tillë e paramasës e bërë në mënyrë manuale nuk është e lejuar duke qenë se kjo kontratë është klasifikuar si kontratë e punës e po ashtu është në kundërshtim me ofertën financiare që prodhohet nga sistemi i e-prokurimit.

Pëerdorimi i kësaj paramase, duke ndarë kontratën e klasifikuar të punës në disa çmime për një pozicion konsiderojmë se është bërë me qëllim që OE të vijnë deri te ngatërrimet e po ashtu për arsy që gjatë procesit të vlerësimit mund të krijohen manipulime dhe në këtë mënyrë mund të rezultojë që vlerësimi të jetë jo objektiv dhe i padrejtë.

Prandaj, kërkojmë nga ana e AK-së që të korrigohet urgjentisht ky gabim në mënyrë që të hiqet kjo paramasë nga dosja e tenderit dhe të vendoset paramasa standarde e aprovar dhe prodhuar nga sistemi e-prokurimi nga KRPP e cila përdoret nga AK dhe të gjitha AK në Republikën e Kosovës.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor pika e parë :

*Duke n' bazuar në kërkesën e juaj lidhur me këtë çështje, ne si AK – Autoritet Kontraktues kemi bërë korrigjin e Paramasës/Parallogarisë dhe si përfundim gjeni Versionin e Korriguar të kësaj të fundit.*

#### Pretendimi ankimor i dytë :

Vlera e parashikuar për realizimin e kontratës në shumën prej 187,049.13€ nuk paraqet pasqyrim të gabuar të analizës financiare dhe gjendjes faktike në krahasim me çmimet aktuale të tregut lidhur

me objektin e kontratës në fjalë duke përfshirë edhe çmimet referente dhe çmimet e kontratave të natyrës së tillë të punës.

Si pasojë e krizës ekonomike në rang botëror ku përfshihet edhe Kosova dhe inflacioni i saj shkon në 20%, ka rritje enorme të materialin ndërtimor dhe punët përcjellëse. Në këtë kuptim bazuar në tregun aktual kostoja mesatare për realizimin e projektit me sukses dhe që mos të dështojë është rreth apo mbi 300,000.00€.

Në këtë mënyrë vlera e parashikuar dhe përcaktuar nga AK në shumën prej 187,049.13€ nuk pasqyrojn koston sipas vlerës reale të tregut si dhe burimeve tjera relevante të materialit dhe punëve ndërtimore dhe nga ana tjetër është përcaktuar në kundërshtim me kriteret e nenit 13.1 dhe 13.3 të Rregullorës Nr. 001/2023 për Prokurim Publik.

Për këto arsyе i kërkojmë AK që nëse ka interes që të realizohet ky projekt me sukses e mos të dështojë, të rishqyrtojë vlerën e parashikuar dhe atë ta përcaktojë nga profesionistë të fushës në krahasim me çmimet e tregut, çmimet e kontratave për natyrën e punës së njejtë si dhe çmimeve referente të publikuara e përditësuara nga Enti i Statistikave të Kosovës dhe çmimeve relevante në raport me krizën ekonomike, respektivisht inflacionit ekonomik.

**Përgjigje në pretendimin ankimore pika e dytë :**

*Ne si njësi kërkuese sa i përket vlerës së parashikuar të kontratës prej 187,049.13 €, nga ana jone është përcaktuar sipas vlerës reale dhe analizës financiare duke u bazuar në çmimet relevante në tregun aktual të materialit si dhe punëve ndërtimore.*

*Që do të thotë se kjo vlerë mbetet e pa ndryshuar dhe mbetet prej operatorëve ekonomik të ofertojnë.*

**Pretendimi ankimore të tretë :**

Aktiviteti i prokurimit me titull: Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" dhe me numër të prokurimit 651-23-2715-5-2-1, nuk është pjesë e planifikimit përfundimtar të prokurimeve për vitin fiskal 2023 të AK-së të dërguar në AQP.

Kërkojmë nga AK-ja që të publokojë në e-prokurimi deklaratën e disponueshmërisë së fondeve duke përfshirë burimin financier - kodin bugjetor me qëllim që të sigurohem se AK i ka në disponim mjetet për të realizuar këtë projekt e mos të befasohemi siç ndodh shpesh herë që në fund projekti t'ë anulohet në formë arbitrarë në mungesë të mjeteve sepse neve si OE pjesëmarrës na shkaktohen shpenzime financiare në përgaditjen e dosjes si dhe dëme të fitimit të humbur.

**Përgjigje në pretendimin ankimore të tretë :**

*Sa i përket pikës 3 gjeni në vijim emailin që ne si AK – Autoritet Kontraktues ju jemi drejtuar AQP-së lidhur me Deklaratën e Disponueshmërisë së Mjeteve.*

### Pretendimi ankimore i katër :

Sipas informatave publike, lidhur me rrugën Adem Jashari ku duhet të zhvillohen punimet sipas këtij projekti ju si AK keni të nënshkruar kontratë me një OE për ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore, rikonstruimin dhe asfaltimin e kësaj rruge.

Sipas legjislativit të prokurimit publik nuk lejohet që për të njejtin projekt të udhëhiqën dy proceura paralele. Se sa është e njoftuar KRPP-ja me këto rrethanë nuk kemi informata sepse po të ishte mendojmë se nuk do të lejonte iniciimin e një proceurë të re paralelisht me një punë e cila është e kontraktuar dhe prodhon pasoja juridike për operatorë ekonomik dhe interesin publik.

Prandaj, kërkojmë nga ana e juaj që për këto rrethana të njoftohet KRPP-ja dhe mos të na krijoni pasoja dhe konteste të panevojshme duke na sjellur probleme, barrë financiare dhe dëme të cilat pastaj vështirë është t'i kompenzojmë, sepse pasojet ekonomike dhe të interesat publike do të jenë të mëdha.

### Përgjigje në pretendimin ankimore i katër :

*Kontrata bazë e kontraktuar do të ekzekutohet me të gjitha pozicionet e parapara në kontratë, ndërsa gjatë koordinimit me Kedsin është konstatuar se nuk mundemi ti përbushim të gjitha nevojat pasi që ka mangësi në paramasë dhe punët shtesë lejohen deri në 10% e cila vlerë nuk i mbulon pozicionet pasi që kemi edhe pozicione të cilat nuk janë të kontraktuar dhe është e domosdoshme që të kontraktohen këtpozicione për përfundimin e infrastrukturës nëntokësore për të ardhur deri te ekzekutimi i kontratës bazë.*

Andaj AK duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit Po ashtu duke pasur në konsideratë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së lidhur me mënyrën më efikase, transparente do të bejë korigimin e dosjes së tenderit konformë rregullave të prokurimit dhe LPP.

Shqipe Hoxha

  
Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.

## RE: - Kërkesë -

Selma Haxhani

Mon 3/27/2023 2:06 PM

To: Prokurimi Gjilan <prokurimigjilan@rks-gov.net>;

Cc: Mehmet Rama <Mehmet.Rama@rks-gov.net>;

Konfirmojmë që keni dorëzuar deklaratën në bazë të nenit 9 pikë 6 të LPP-së.

**Me respekt**

Selma Haxhani

Zyrtare e Prokurimit

Agjencia Qendrore e Prokurimit

Ndertesa e Gërmis, kati IV, Zyra A 402,

Tel: 200 15 506

<http://aqp.rks-gov.net/>

Kjo shkresë elektronike është e besueshme dhe e paraparë për përdorim vetëm nga ata që u është adresuar. Nëse gabimisht e keni pranuar këtë shkresë elektronike, ju lutemi fshijeni ose na informoni me telefon apo shkresë elektronike kthyese.

---

**From:** Prokurimi Gjilan

**Sent:** Monday, March 27, 2023 12:00 PM

**To:** Selma Haxhani

**Cc:** Shqipe A Hoxha

**Subject:** - Kërkesë -

E nderuar

E gjeni të bashkangjitur Deklarataen e disponshmeris se mjeteve per aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari"

Presim konfirmimin e e-mailit nga ana juaj

**Me respekt!**

Departamenti i prokurimit

Komuna e Gjilanit